


NE E DUAM



DEMOKRACINË

SHTËPIA E DEMOKRACISË

ARIJANIT (9), ILIRA (9), GJENIS (9), DELFINA (9), VESA (9), SARA (9)



Ne sot, fëmijët nga klasa IV-1 nga shkolla „Nazim Gafurri“ mësuam për shtëpinë e demokracisë - Kuvendin e Kosovës.

Në demokraci, pushtetin në dorë e ka populli. Kjo do të thotë se ne kemi të drejtë të shfaqim mendimet tona, dhe jemi të lirë të zgjedhim gjërat që na pëlqejnë. Kur ne t'i mbushim 18 vjet, kemi të drejtë të zgjedhim deputetët të cilët do të na përfaqësojnë neve më së miri. Këta deputetë do të punojnë në Kuvendin e Kosovës. Kuvendi i ka 100 deputetë, nga ata 100 janë qytetarë shumicë të Kosovës, kurse 20 prej tyre vijnë nga komunitetet jo shumicë. Në Kosovë jetojnë këto komunitete jo shumicë: ashkali, romë, turq, boshnjak, egjiptian dhe serb.

Detyrat e Kuvendit të Kosovës janë të përfaqësoj shtetin dhe popullin, të miratoj dhe të shfuqizoj ligje, të zgjedhë Qeverinë e Kosovës dhe të mbikëqyr punën e saj, të zgjedhë Presidentin dhe të zgjedhë Kryetarin

e Kuvendit. Ne gjithashtu, mësuam mbi funksionet e Kuvendit, të cilat janë: funksioni përfaqësues, sepse i përfaqëson qytetarët e Kosovës, funksioni legjislativ apo ligjvënës, dhe funksioni i kontrollit, sepse e kontrollon punën e Qeverisë. Deputetët, sipas bisedës tonë kanë të drejtë po ashtu të propozojnë ligje, si kurse Qeveria, Presidenti, dhe 10.000 qytetarë. Këto ligje shkruhen në librin e madh të ligjeve që quhet Kushtetutë. Edhe ne, në moshën 18 vjeçare mund të zgjedhemi si deputetë, si Kryeministër apo ministër, dhe si President. Të gjithë përfaqësuesit tonë duhet të jenë të ndershëm me qytetarët, duhet të jenë të drejtë dhe të respektojnë ligjet, si dhe duhet të punojnë për ne. Nëse ata nuk punojnë mirë, shteti ynë nuk do të jetë aq i fortë, dhe ata mund të largohen nga detyra e tyre. Ne do të zgjedhim dikë tjetër, që është më i aftë në këtë punë, që shteti ynë të ketë zhvillim, jetë më të mirë dhe të lumtur.



Ne, fëmijët duke vizatuar



Vizatimi ynë për funksionet e Kuvendit të Kosovës

ZGJEDHJET DHE NE

JAKUP (10), KREMTIM (9), ALBIN (10), SARA (9), EMIRJON (9), SUELA (9)

Ne sot mësuam për zgjedhjet dhe votuam për njërin-tjetrin

Zgjedhjet janë një proces shumë i rëndësishëm për ne, sepse zgjedhim përfaqësuesit tonë. Ne bëjmë zgjedhje të ndryshme në përditshmëri, mirëpo në procesin zgjedhor kemi të drejtë të marrim pjesë kur t'i mbushim 18 vjet, sepse jemi më të pjekur.

Në vendin tonë kemi dy lloje të zgjedhjeve e ato janë: qendrore dhe lokale. Zgjedhjet qendrore janë kur zgjedhim deputetët, pra përfaqësuesit tonë.

Ndërkaq zgjedhjet lokale janë kur e zgjedhim kryetarin e komunës dhe asambleistët. Në Kosovë ekziston vetëm një zonë zgjedhore.


Ne mendojmë për të ardhmen tonë, prandaj ne kur të rritemi do të votojmë. Ne gjithashtu, do të mësojmë shumë mirë që në të ardhmen të mund të jemi edhe ne deputetë.



Autorët e artikullit „Qershia“



Gratë dhe burrat janë të barabartë në votim



Ne do të votojmë pasi të mbushim 18 vjet



Vota jonë do të bëjë një ndryshim në shtetin tonë



Mendimet tona rreth votimit

TË DREJTAT TONA

ELVIRA (10), ARDIT (10), FATBARDHA (9), LEDION (9), ERBLIN (10)

Ne jemi klasa IV-1 dhe do t'iu tregojmë më shumë për të drejtat tona dhe për rolin tonë në shtëpinë tonë, shkollën tonë, lagjen tonë, shtetin tonë, kontinentin tonë dhe në planetin tonë

Të gjithë jemi qytetarë të Kosovës dhe shteti jonë na jep të drejta që nga lindja. Ne si fëmijë kemi shumë të drejta, por në artikullin tonë do t'iu tregojmë disa prej tyre. E ato janë e drejta e shkollimit, e drejta e lojës, si dhe ne kemi të drejtë të mësojmë dhe të shprehemi lirshëm. Ne jemi të rëndësishëm, sepse kemi role të mëdha. P.sh., unë duhet të respektoj mamën ose babin, t'i dëgjoj ata se çfarë më thonë, duhet t'i mbaroj detyrat e mia, duhet t'i ndihmoj mamit me punët e shtëpisë. Unë në shkollë e respektoj mësuesen, shokët dhe shoqet. Dhe duhet të mësoj dhe t'i respektoj rregullat. Unë nuk duhet të prish qetësinë në lagje, t'i ndihmoj lagjes sime dhe të sillem mirë me të tjerët. Në shtetin tonë, ne duhet të respektojmë rregullat e komunikacionit. Duhet të kalojmë rrugën vetëm kur është drita e gjelbër. Ndërsa në fund, roli ynë në kontinent apo në planetin tonë është të mos hudhim mbeturina dhe të kursejmë ujin, për arsye se ka shumë vende në botë që nuk kanë ujë të pijshëm.



Pema e vizatuar nga grupi



Autorët e „Qytetarisë Aktive“



Erbliri dhe Arditi duke lexuar të drejtat e njeriut



Fatbardha dhe Elvira duke vizatuar shkollën

TË PUNOJMË TË GJITHË SË BASHKU

RIJETA (9), TEFIK (9), ALTIJON (10), ALMIRI (9), ERIS (10)

Ne kënaqemi së bashku në demokraci

Ne sot mësuam se demokracia është udhëheqje e popullit. Janë dy lloje të demokracisë: përfaqësuese dhe e drejtpërdrejtë.

Disa nga elementet kryesore të demokracisë janë: respekti, liria, toleranca, paqja dhe barazia. Ne në demokraci kemi të drejta të barabarta, pra të gjithë jemi të barabartë. Kemi të drejtë të luajmë, të ushtrojmë, të pushojmë, të lexojmë, t'i shprehim mendimet tona etj. Liria është kur ne jemi të lirë të bëhemi çfarë të dëshirojmë. Respekt do të thotë të dëgjojmë njëri-tjetrin. Toleranca është shumë e rëndësishme në demokraci, prandaj ne duhet të kemi mirëkuptim së bashku.



Ne jemi të lumtur në demokraci



Këto janë elementet e demokracisë




Ne bashkëpunojmë në demokraci



Liria



Ne kemi të drejtë të lexojmë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
 REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
 REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
 Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
 Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
 TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit
 Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Nazim Gafurri“
 E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IV-1
 Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë